



POLICY MEMO

Përmirësimi i koordinimit institucional dhe komunikimit me publikun në kohën e emergjencës së shëndetit publik

Qëllimi

Me gjithë punën e mirë që po bën Qeveria në përgjithësi dhe Ministria e Shëndetësisë me trupat e saj profesional në veçanti, rreth menaxhimit të emergjencës së shëndetit publik të shkaktuar nga COVID-19, janë disa aspekte të cilat kanë hapësirë për përmirësime dhe rrjedhimisht kontribuojnë në menaxhim më të mirë të kësaj situatë.

Prandaj, qëllimi i këtij dokumenti të shkurtër është që të ofrojë disa rekomandime për Qeverinë në lidhje me tri aspekte që përbëjnë edhe problemin e adresuar në këtë dokument:

- 1) Rritjen ose përmirësimin e koordinimit institucional në menaxhimin e pandemisë së shkaktuar nga COVID-19;
- 2) Përmirësimin dhe unifikimin optimal në komunikimin e Qeverisë me qytetarët; dhe
- 3) Publikimin e vendimeve dhe njoftimeve lehtë të qasshme për publikun;

Problemi

Siç edhe mund të kuptohet nga qëllimi i përcaktuar më lartë, problemi i identifikuar në këtë dokument lidhet me tri elemente: e para, koordinimi institucional, e dyta, komunikimi me publikun dhe e treta, qasja e publikut në vendimet dhe njoftimet e Qeverisë. Të tri elementet trajtohen ndaras në vijim, gjithmonë në kontekst të situatës së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19.

1. Koordinimi institucional

Për të ilustruar mungesën e koordinimit adekuat institucional në kohën e pandemisë, po japim disa shembuj si në vijim. Rastet e para me koronavirus (COVID-19) në Kosovë janë konfirmuar nga Qeveria përmes një konference për media me datë 13 mars 2020¹ kurse tri ditë më herët, përkatësisht me 10 mars, Qeveria kishte aprovuar kërkesën e Ministrisë së Shëndetësisë për aprovimin e Planit për

¹ Kosova konfirmon dy rastet e para me koronavirus (COVID-19): <https://bit.ly/3aD2QU4>

gatishmëri dhe reagim kundër koronavirusit dhe Planin e veprimit.² Në anën tjetër, me 15 mars Qeveria merr vendim për shpalljen e emergjencës për shëndetin publik dhe kërkon që të vepohet sipas Planit të Reagimit Kombëtar dhe Ministria e Shëndetësisë caktohet si përgjegjëse për menaxhimin e situatës së shpallur të emergjencës së shëndetit publik. Pyetja që lind këtu është se cili ishte Plani për gatishmëri dhe reagim dhe Plani i veprimit i Ministrisë së Shëndetësisë i miratuar me 10 mars që u tregua i pamjaftueshëm që pastaj të kalohet në Planin e Reagimit Kombëtar? Ky i fundit megjithëse është dokument qeveritar, është i hartuar nga Ministria e Punëve të Brendshme (kryesisht nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent) dhe më shumë është dokument i menaxhimit të incidenteve të tipit të katastrofave natyrore bazuar në Ligjin për menaxhimin e fatkeqësive natyrore se sa i natyrës së menaxhimit të një pandemie ku veprimet e Ministrisë së Shëndetësisë bazohen në Ligjin për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse.

Për më shumë, Qeveria me datë 12 mars themelon Komisionin e Posaçëm i kryesuar nga Kryeministri për Parandalim të koronavirusit (COVID 19) me qëllim të menaxhimit të tërë procesit në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Sekretariati Koordinues i Qeverisë (SKQ) caktohet si një trup që i ofron mbështetje administrative këtij komisioni.³ Pra, pyetja tjetër që lind këtu është se a do të menaxhojë situatën ky Komision i Posaçëm i themeluar me 12 mars, apo do të jetë Ministria e Shëndetësisë sipas vendimit të datës 15 mars i cekur më lartë? Për më shumë, me 17 mars me kërkesën e Presidentit mbahet mbledhja e Këshillit të Sigurisë së Kosovës (KSK) për të diskutuar rreth menaxhimit të situatës së pandemisë, nevojës për të shpallur gjendje të jashtëzakonshme dhe mekanizmit institucional që duhet të menaxhojë këtë situatë. Për dallim nga Komisioni i Posaçëm i krijuar *ad-hoc*, KSK ka dy trupa mbështetës permanent: Sekretariatit me qëllim të përgatitjes së mbledhjeve dhe propozimit të analizave në KSK dhe Qendrën e Situatave me qëllim të mbledhjes së informacionit dhe informimin e Kryeministrit dhe KSK-së mbi situatën e sigurisë, në këtë rast situatën me menaxhimin e pandemisë të shkaktuar nga COVID-19.⁴

Një tjetër pyetje është se pse duhet të krijohet një Komision i Posaçëm (dhe të caktohet SKQ si organ mbështetës i komisionit) kur nga viti 2008 ekziston i themeluar me ligj KSK i cili mblidhet edhe në situata normale dhe ka Sekretariatit si organ mbështetës të tij? Kjo edhe aq më shumë kur Komisioni i Posaçëm i krijuar *ad-hoc* nuk ka kompetenca ekzekutive njësoj sikurse KSK, por vetëm i propozon Qeverisë masat për aprovim dhe njëjtë KSK do të mund të propozonte në Qeveri masat për miratim rreth menaxhimit të pandemisë në fjalë.

Pastaj, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike me 19 mars merr vendim për aktivizimin e Planit të Reagimit Kombëtar dhe themelohet Grupi Ndër-Institucional për Menaxhimin e Incidenteve i koordinuar nga Zv. Ministri i Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike kurse anëtar janë disa ministra (Ministri i Shëndetësisë një prej anëtarëve) dhe institucione tjera.⁵ Në këtë rast, a ishte aktivizuar Plani i Reagimit Kombëtar me vendimin e Qeverisë me 15 mars apo duhej të aktivizohej prapë nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike me 19 mars? Dhe, a është Komisioni i Posaçëm i krijuar me 12 mars duke menaxhuar situatën, apo Ministria e

² Qeveria e Kosovës, Vendimi nr. 04/06 i datës 10.03.2020: <https://bit.ly/2Y79L51>

³ Qeveria e Kosovës, Vendimi nr. 01/08 i datës 12.03.2020: <https://bit.ly/3aDĚ4NM>

⁴ Ligji nr. 03/L-050 për themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës, Nenet 16, 17: <https://bit.ly/2KCMK1S>

⁵ Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike, Vendimi nr. 112/2020 i datës 19.03.2020: <https://bit.ly/3aydSK1>

Shëndetësisë e autorizuar me 15 mars apo është Grupi Ndër-Institucional për Menaxhimin e Incidenteve organi që po e menaxhon këtë situatë?

2. Komunikimi me publikun

Elementi i dytë i problemit ka të bëjë me komunikimin e Qeverisë si tërësi me publikun rreth menaxhimit të emergjencës së shëndetit publik shkaktuar nga COVID-19. Ajo që kemi parë deri tani është se Qeveria ka folur/ komunikuar më së paku me një zë me publikun sepse vendime dhe qëndrime të Qeverisë janë komunikuar nga Kryeministri, Zv. Kryeministri i Parë, Zv. Kryeministri i Dytë, Zëdhënësi i Qeverisë dhe disa ministra veç e veç sipas fushave të tyre të punës si Ministri i Shëndetësisë, Ministria e Ekonomisë, Punës, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike, Ministri i Infrastrukturës dhe Ambientit, U.D. i Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike dhe përfaqësues nga institucione tjera profesionale.

Derisa fakti që ka pasur komunikim të informatave nga Qeveria është pozitiv, fakti që ato janë komunikuar nga shumë persona dhe në orare të ndryshme, ka ndikuar në mos konsistencën e komunikimit dhe ka vështirësuar ndjekjen e të gjitha njoftimeve nga qytetarët. Për shembull, komunikimi i masave rreth shtyrjes së afatit të pagesave të qytetarëve ndaj ndërmarrjeve publike, shtyrjen e afateve për deklarimin e obligimeve tatimore etj., janë komunikuar nga Zv. Kryeministri i Parë, z. Hoti në konferencën për media me datë 15 mars.⁶ Pastaj, qëndrime dhe njoftime janë dhënë nga Zv. Kryeministri i dytë z. Abazi bashkë me zëdhënësin e Qeverisë me datë 17 mars dhe të tjera komunikime gjatë kohës nga zëdhënësi i Qeverisë dhe ministrat veç e veç. Për shembull, njoftime për biznese janë dhënë nga Ministria përkatëse, njoftime për mundësinë e kthimit të qytetarëve që kanë mbetur jashtë Kosovës janë komunikuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, pastaj njoftime rreth transportimit dhe mënyrës së transportimit janë komunikuar nga Ministri i Infrastrukturës dhe Ambientit, etj.

3. Publikimi i vendimeve dhe njoftimeve

Krahas vendimeve të Qeverisë, janë edhe 14 vendime tjera që i ka marr Grupi Ndër-Institucional për Menaxhimin e Incidenteve në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike të cilat edhe pse janë në faqe të kësaj ministrie, më shumë janë komentuar në media se sa që qytetarët i kanë gjetur dhe lexuar ato. Për shembull, në mesin e tyre ka vendime rreth vlefshmërisë së dokumenteve personale të cilave i'u ka skaduar afati në këtë kohë, vendime rreth qarkullimit të njerëzve, bizneseve, kompanive, automjeteve dhe vendime tjera të rëndësishme për qytetarët.

Pastaj, vendime të marra nga Ministri i Financave dhe Transfereve që ishin komunikuar si plane për t'u miratuar në Qeveri në konferencën për media të datës 15 mars nga z. Hoti, gjenden në faqen e Administratës Tatimore të Kosovës.⁷ Ngjashëm me këtë, vendime dhe njoftime gjenden ndaras në faqe të Ministria e Ekonomisë, Punës, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investime Strategjike,⁸ Ministrisë së Infrastrukturës dhe Ambientit,⁹ etj.

⁶ Zëvendëskryeministri i parë i Kosovës mban konferencë për media, 15.03.2020: <https://bit.ly/2Ē0Oebx>

⁷ Administrata Tatimore e Kosovës, datë 19.03.2020: <https://bit.ly/2Y4J6ĒF>

⁸ Ministria e Ekonomisë, Punës, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike: <https://bit.ly/2VĒm3KV>

⁹ Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit, njoftim me rëndësi: <https://bit.ly/3aEHcPh>

Derisa publikimi i vendimeve dhe njoftimeve është pozitiv, fakti që këto janë shumë të shpërndara e bënë më të vështirë për shumë qytetarë që t'i gjejnë këto vendime për shkak se duhet kërkuar në shumë vende, ka bërë që qasja e qytetarëve në vendime dhe njoftime tjera të Qeverisë të jetë problem për qytetarët.

Ja vlen te përmenden edhe komunikatat kundërthënëse te qeverise vs presidencës, masat qe komunikoheshin nga qeveria, kundërshtoheshin nga presidenti i cili edhe bënte thirrje qe te mos përfillen. Pastaj ja vlen te përmendet edhe puna e "shpalljes se gjendjes emergjente". Pak me përfshi se çka do te thotë ajo (se plot njerëz edhe nuk e dine) edhe se si një ministër ka dal me qëndrim te kundërt prej atij te qeverise, e kështu me rradhë. Këto 2 ngjarje për mu janë dështime te sektorit publik ne menaxhim te situatës se pandemisë, tash mundemi me ja lanë fajin individëve por ne përgjithësi është një dështim para qytetareve sepse ka kriju panik edhe amulli.

Rekomandime

Sipas tri elementëve të problemit, mund të jepen disa rekomandime specifike për evitimin e tyre:

Koordinimi institucional

- Qeveria duhet të caktojë vetëm një trup ndër-ministror (komision, këshill, grup) si përgjegjës për menaxhimin e situatës;
- Pavarësisht se cili është mekanizmi institucional, Ministria e Shëndetësisë duhet të jetë udhëheqëse e këtij trupi ngase natyra e emergjencës është në lidhje me punën e Ministrisë së Shëndetësisë;
- Qeveria, nëse vendos që trup tjetër nga Këshilli i Sigurisë së Kosovës duhet të menaxhojë këtë situatë, prapë duhet të mbledhë më shpesh Këshillin e Sigurisë së Kosovës në situatë normale përmes të cilit siguron koordinim edhe me institucione përtej Qeverisë, sikurse zyra e Presidentit dhe Kuvendi i Kosovës (komisioni për siguri) të cilët janë anëtarë. Anëtarë shtesë me status të përkohshëm mund të ftohen nga Kryeministri sipas nevojës;
- Kryeministri duhet të delegojë të drejtën e kryesimit në baza të rregullta të mbledhjeve të Këshillit të Sigurisë së Kosovës tek Ministri i Shëndetësisë, kurse vet mund të kryesojë vetëm në raste të veçanta dhe sipas nevojës;

Komunikimi me publikun

- Ministri i Shëndetësisë (eventualisht Kryeministri) duhet t'u adresohet qytetarëve rreth menaxhimit të situatës së pandemisë;
- Informatat e përditësuara në baza ditore duhet të jepen nga zëdhënësi i Qeverisë, në një orë të caktuar;

Publikimi i vendimeve dhe njoftimeve

- Qeveria, përkatësisht shërbimet e teknologjisë informative në zyrën e Kryeministrit, duhet të formojë një faqe për plasim të të gjitha informatave për qytetarët që lidhen me pandeminë të shkaktuar nga COVID-19;
- Publikimi i të gjitha informatave në një faqe nuk do të thotë që institucionet nuk duhet t'i publikojnë ato edhe në faqet e tyre respektive, por që gjatë kohës së pandemisë dhe me qëllim të qasjes më të lehtë nga qytetarët, ato duhet të jenë në një faqe;

- Qeveria duhet të obligojë të gjitha ministrinë që informatat për qytetarët t'i dërgojnë në shërbimet e teknologjisë informative në zyrën e Kryeministrit për plasim në faqen përkatëse;